



AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS
REGULATORNI AUTORITETE ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS
ARKEP

Reg./No. 359/2/22

Faq./Br. Str./No. Pg. 1

Data/Date 20-10-2022

PRISHTINË - PRISTINA - PRISHTINA

Data:	11/07/2022
PËR/ZA/TO:	Zyrën Kombëtare të Auditimit, ZKA
CC:	Faruk Prebeza, Auditor Ligjor, ETIKA Fatmir Gërvalla, Zyrtar Kryesor Financiar, ARKEP
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Nazim Rahimi, Kryetar i Bordit, ARKEP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i veprimit në adresimin e përbushjes së rekomandimeve të dhëna përmes raportit të Auditimit për vitin 2021

Përshëndetje,

Konform obligimeve ligjore bashkangjitur gjeni planin e veprimit në adresimin e përbushjes së rekomandimeve të dhëna për vitin 2021.

Me respekt;

Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. Bedri Pejani, Nr; 23, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 212-345; Fax: +383 38 212 399;

E-mail: info@arkep-rks.org; ueb-site: www.arkep-rks.org

Prishtinë, 11 Korrik, 2022

**Plani i Veprimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA për viti e Auditimit 2021
 (Raporti i Auditimit nga ZKA)**

Kapitujt e Raportit	Të Gjeturat & Rekomandimi-et	Veprimet e ARKEP në adresim të /rekomandimit-eve	Verifikimi i Përmbushjes
Çështja 1) - Pranimi i pajisjeve pa komision të pranimit			
E gjetura;1	Sipas nenit 8 pika 4, të Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo kapitale në organizatat buxhetore, Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare që ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar dhe të dokumentuar me procesverbal që janë në përputhje me kontratën apo urdhërblertjen. Gjatë testimit në një pagesë në vlerë 780€, kemi vërejtur që për ato blerje të pasurive nuk kishte vendim të komisioni dhe as raport të pranimit, përveç nënshkrimit të zyrtarit të pranimit në depo. Kjo kishte ndodh për shkak të kujdesit jo të duhur që para pranimit të pasurive të formohet	Kryetari i Bordit ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme duke njoftuar stafin që raste të tilla të mos përsëriten me.	Rekomandim i përmbushur

	komisioni.			
<i>Rekomandimi;1</i>	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë që pranimi i mallit të blerë, të bëhet vetëm nga komisioni i autorizuar, për të konfirmuar se furnizimet janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë			
Çështja 2) - Mos regjistrimi i pasurive në sistemin e-pasuria				
E gjetura;	Sipas nenit 6 paragrafi 3 i Rreg. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria". Gjatë testimeve kemi vërejtur që ARKEP nuk kishte regjistruar blerjet e vitit në regjistra të pasurive mbi dhe nën 1,000€. Këto pagesa janë si në vijim: • Pagesa për pajisje tjera në vlerë 780€; • Pagesa për blerje të tek informative në vlerë 32,843.34€ (në dy pagesa 17,500€ dhe 15,343.34 €, nuk ishte regjistruar vlera 5,259.92€); • Pagesa për pajisje të tek informative në vlerë 7,092€; dhe • Pagesa për blerje të pajisjeve për harduer në vlerë 19,500€. ARKEP në PFV e saj kishte shpalosur te neni 19 se nga këto pagesa vlerën prej 26,592€ nuk kishin arritur të regjistronin në SIMFK ndërsa sa i përket pasurive të e-pasuria për vitin 2021		Kryetari i Bordi ka ndërmarr veprimet e nevojshme lidhur me përmbushjen e rekomandimit sa i përket regjistrimeve të pasurive në sistemin e cilat përdoren nga institucionet publike. Por duhet pasur parasysh se sistemi e-pasuria është softuerë të cilin e menaxhon ASHI dhe të njëjtit kanë qenë të njoftuar përmes email-ave 10 here radhas nga zyrtarja e pranimit dhe ZKF por ASHI nuk kanë ndërmarr asnjë veprim për të mundësuar regjistrimin e pasurive në sistem me arsyetimin se nuk ka kontratë të mirëmbajtjes. Ndërsa të gjitha pasurit mbi 1000 euro janë regjistruar në sistemin e Free Balanc-it	Rekomandim i përmbushur raporti i pasurive dhe e-pasurisë

	<p>nuk ishte shpalosur fare për mos prezantimin e tyre në PFV. Për këto pasuri, vlera e prezantuar në PFV është e nënvlerësuar duke mos prezantuar vlerën e drejtë të tyre. Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrollit jo të mirë. Arsyeja e mos regjistrimit ishte pasi që ARKEP kishte kërkuar me datën 18.01.2022, pas afatit të lejuar të regjistrojë pasurinë të cilën e kishte blera gjatë nëntorit dhe dhjetorit të vitit 2021.</p>			
<i>Rekomandimi;2</i>	<p>Kryetari i Bordit duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.</p>			